

VENDIM
Nr.54, datë 23.11. 2004

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE
SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT” SHA TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1, neni 15 ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë”, pika 3 dhe pika 4, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.11.2004 mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OST” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme nuk janë plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1, ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë, pika 3, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” ndarjen e plotë të llogarive financiare nga “KESH” sh.a., si dhe raportin e ekspertit kontabël.

II. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë pika 4, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a për “OST” sh.a.

III. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa c pika 3, neni 11 pika 2 paragrafi 3:

i) lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e transmetimit;

ii) realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes.

Në bazë të konstatimeve të përmendura më sipër Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës për transmetimin e energjisë elektrike shoqërisë: “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë me një afat kohor deri më datë 31.12.2005.

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria “OST” sh.a., brenda datës 31.12.2005, të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) Ndarjen e plotë të llogarive financiare nga “KESH” sh.a. në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1;

ii) Hartimin dhe paraqitjen e raportit të ekspertit kontabël në ERE në zbatim të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” neni 251, 256 dhe urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 3;

iii) Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a. për “OST” sh.a në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a Tiranë” pika 4, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2;

iv) Lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e transmetimit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 3;

v) Realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me

“Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 2 paragrafi 3;

vi) Pasqyrimin në statutin e shoqërisë “OST” sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhërin e Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema